



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr.382/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. Refuzohet e pabazuara ankesë e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.382/2025, të datës 05.02.2025.

Paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025

A r s y e t i m

Me datën 05.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër A.nr.382/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

-Në ankesë Anr.382/2025 pretendohet se më datë 4 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), pjesë e strukturave në qendrën e Lëvizjes Vetëvendosjenë Gjermani, z. Fahri Beqa ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook, me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "*këto janë zgjidhje ku detyrohesh me votu për mos me i kthy plaçkitësit e shtetit në pushtet; dhe mos me kthy serbinë dhe kriminelët e saj në veri..*", kështu duke përdorur gjuhë nxitëse, përçmuese, lincuese dhe përçarëse ndaj subjekteve kundërshtarë të LVV-së. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se përmbajtja e këtyre

deklaratave pamëdyshje përbën përdorim të gjuhë fyese dhe denigruese ndaj subjekteve kundërshtarë politike, përmes së Cilave ka cenuar rëndë integritetin dhe dinjitetin e subjektit politik të tyre, Partia Demokratike e Kosovë (PDK).

Ankesës ka bashkangjitur si provë, Postimi i publikuar nga mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Fahri Beqa, në rrjetin social Facebook; Fotografi të realizuar nga Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në germani; Foto me kryetarin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje; <https://www.facebook.com/fahri.beqa/posts/Pfbid02jVBCpAFrCZEJgxPZGpQ6BmwY4zUhdUAWCKsZEUa2XsgQKqkKb6bTmTupxKI5I>

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), theksohet se, pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura të ankesës Anr.382/2025 në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se z.Fahri Beqa ka postuar një shkrim me përmbajtje sikurse i referohet ankuesi në këtë ankesë. Nga fotografia e bashkangjitur ankesës konstatohet se z.Fahri Beqa ka rishpërdarë një postim të Shkelzen Gashit ndërsa nga prova të cilës i referohet ankuesi nuk mund të kuptohet koha kur është shkruar ky shkrim nga z.Shkelzen Gashi dhe për cilat zgjedhje bëhet fjalë.

Kërkojnë nga PZAP-i, që të refuzohet ankesa në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave materiale të bashkangjitura, ka gjetur se personi i quajtur Fahri Beqa ka shpërndarë një postim në emër të Shkelzen Gashit në rrjetin social Facebook, me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "*këto janë zgjidhje ku detyrohesh me votu për mos me i kthy plaçkitësit e shtetit në pushtet; dhe mos me kthy serbinë dhe kriminelët e saj në veri..*". Paneli vlerësoi se në rastin konkret nuk kemi të dhëna që e bëjnë të besueshëm faktin se kemi të bëjmë me mbështetës apo kandidat të subjektit politik LVV dhe postimi në fjalë ka qenë i shkruar nga person tjetër jo nga personi me të cilën ka pretenduar pala ankuese andaj nuk mund të konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë shprehimore thuhet se: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*".

Andaj në rastin konkret në mungesë të provave bindëse paneli, duke bazuar në nenin 117 paragrafi 3, në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr.382/2025 më datën 07.02.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

